



Nr. 7 Prot

Datë, 27.03.2020

**VENDIM**  
**Nr. 3, datë 27.03.2020**

**PËR**

**SHTYRJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUS TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË.**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3, të Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; Vendimit Nr. 2 , datë 24.03.2020 "Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtus të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore" si dhe Urdhërit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 99, datë 26.03.2020 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 8, datë 14.01.2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë".

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shtyrjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtus të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 24.04.2020, deri në datën 28.04.2020, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidatit i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Teknike në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në sitin zyrtar [www.univlor.edu.al](http://www.univlor.edu.al).
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit**  
**Elmira Kushta**

**Anëtarët**

**Alma Sheko**  
**Alba Rustemaj**